



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:267520

Datë: 20.11.2020

Numri i dokumentit: 01287619

A.nr.1009/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me zyrtaren ligjore Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit S.R., nga P., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: ndëshkim administrativ, në seancën publike të mbajtur me datë 03.11.2020, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditësit S.R., nga P., si e pabazuar.

Mbetet në fuqi Vendimi nr.103/2019 datës 03.04.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (ATK) ka refuzuar ankesën e paditësit si e pabazë, dhe Dokumentin mbi Vendosjen e Ndëshkimit nr.numër..., i datës 28.02.2019 në vlerë prej 30,000.00€ dhe ndëshkimin ne. numër..., dt.10.02.2019 në vlerë prej 1,000.00€, i ka vërtetuar si të bazuar.

Paditësi S.R., nga P., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 26.04.2019, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovet padia, të anulohet vendimi nr.103/2019 datës 03.04.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Në padinë e tij, paditësi deklaron: e paditura nuk ka vërtetuar në mënyrë drejt dhe të plotë gjendjen faktike dhe nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore, për shkak se nuk qëndron ajo se vizita ka qenë vetëm tek lokali ynë po ka qenë një aksion që ka përfshirë të gjithë lagjen Santea në Dardani, sa i përket dispozitave ligjore e paditura nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 57 paragrafi 1 i Ligjit 04/L-080 për Lojërat e Fatit. E paditura nuk ka asnjë fakt se në lokal janë gjetur paisje për lojëra por vetëm është bazuar në qipat të cilët kanë mbetur nga një biznes tjetër që e ka ushtruar veprimtarin e Kazinos Royall Game deri në vitin 2012 për të dëshmuar faktin se lokali ka qenë me qira deri në vitin 2012 shumë lehtë verifikohet në bazë të dhënave që i ka në sistem ATK-ja, mirëpo nuk e ka bërë një gjë të tillë, pastaj tavolinat janë të thjeshta dhe nuk janë tavolina në të cilat luhen lojërat që ceken ne

nenin 57 të Ligjit për Lojërat e Fatit, përveç kësaj për të luajtur lojëra të kazinos duhet të kesh edhe para, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur sepse kemi qenë shoqëri dhe jemi argëtuar me letra. E paditura ka vendos gabimisht sepse neni 77 par.1.8 të Ligjit për lojërat e Fatit nuk është dashur të aplikohet sepse nuk ka të bëjë me libra dhe regjistrime, në rastin konkret është dashur të aplikohet nenin 53 i Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe neni 43 pika 97 e UA 15/2020, sepse e paditura nuk ka mund të vërtetojë se paditësi ka ushtruar veprimtari të biznesit.

E paditura në përgjigje në padi datës 13.09.2019 deklaroi: ATK-ja ka kryer vizitë sipas aktiviteteve AU005 në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në adresën Bill Clinton-te Santea Prishtinë, gjatë kësaj vizite inspektori i aludimit ka kryer çështjen e hyrjeve dhe daljeve-librave ndërsa inspektori i licencimit për veprimtarin e lojërave të fatit, me këtë datë lokalit i është vendos shiriti nga ATK dhe nuk janë konfiskuar paisjet që kanë qenë në lokal. Me datën 24.12.2018 përsëri është vizituar lokali dhe janë konfiskuar si dëshmi dy valixhe me qipa dhe 5 kutia me letra pokeri. Nga dëshmit e siguruara si tavolina e improvizuar, kutit me qipa dhe letrat, është konstatuar se në këtë lokal është ushtruar veprimtari e lojërave të kazinos dhe sipas Ligjit 04/L-080 për Lojërat e fatit neni 76 ndëshkohet paditësi me gjobë 30,000.00€, po ashtu për shkak të mos mbajtjes dhe mos ofrimit të librave dhe regjistrimeve me datë 10.02.2019 paditësi është ndëshkuar në vlerë prej 1,000.00€ bazuar në nenin 77.1.7 të Ligjit 04/L-080 për Lojërat e Fatit. Mbi bazën e fakteve të paraqitura i propozojmë gjykatës të marr aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ATK-së DA nr.103/2019 dt.03.04.2019 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 03.11.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 13.09.2019 nga ATK-ja, Vendimi nr. *numër...*, ATK dt.03.04.2019 i ATK-së, ankesa e paditësit me nr.prot.103/2019 e dt.03.04.2019, Dokumenti i vendosjes së ndëshkimit dt.28.02.2019 dhe 10.02.2019, shikimi në foto-dokumentacionin, Kontrata e punës e dt.01.12.2010, Forma për vizitat përmbushëse, të dt.28.02.2019, 31.01.2019, 24.12.2018 dhe 20.12.2018, nga ATK-ja, Gjendja lidhur me të gjitha ndëshkimet e tatimpaguesit.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Në arsyetimin e vendimit kontestues theksohet se gjatë aktivitetit të zhvilluar nga inspektorët tatimor me datë 20.12.2018 dhe 24.12.2018 në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, në lokalit e paditësit janë zhvilluar lojërat e fatit-kazino pa u licencuar dhe janë gjetur prova si: dy kufera me qipa të pokerit. Letrat e zholit dhe disa tavolina, nga të cilat prova është konstatuar se paditësi ka zhvilluar aktivitetin e kazinos pa leje të organit kompetent dhe të njëjtut i është shqiptuar ndëshkimi sipas nenit 76 paragrafi 1.1 të Ligjit 04/L-080.

Gjykata konsideron se me Ligjin 04/L-080 për Lojëra të Fatit me të cilin është rregulluar mënyra e organizimit dhe funksionimit të lojërave të fatit, përveç tjerash janë përcaktuar edhe kushtet që duhet plotësuar subjektet e çertifikuara nga ATK-së për ushtrimin e lojërave të fatit, sa i përket licencës që duhet të merret për tu ushtruar kjo veprimtari. Nga interpretimi i dispozitave të nenit 76 par.1.1 të Ligjit 04/L-080 për Lojërat e Fatit, gjykata vlerëson se e paditura ATK-së ka vepruar drejtë kur me Dokumentet e vendosjes së ndëshkimit dt.10.02.2019 i ka shqiptuar paditësit gjobat administrative për shkak se ka ushtruar veprimtari të lojërave të fatit pa poseduar licencë, dhe në anën tjetër paditësi nuk ka ofruar librat dhe regjistrimet dhe i njëjti është ndëshkuar në bazë të nenit 77 paragrafi 1.8 të Ligjit 04/L-080 për Lojërat e Fatit.

Gjykata pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se provat e gjetura në lokalitetin e paditësit janë prova të mjaftueshme për tu dëshmuar fakti se në lokalitetin e paditësit është zhvilluar aktiviteti i kazinos, me të cilat veprime paditësi ka rënë ndesh me dispozitën e nenit 25 paragrafi 1.1 të Ligjit 04/L-080 që parasheh: Licenca për kazino kërkohet për çdo person që ushtron veprimtari, drejton, ose ekspozon për çdo lloj loje të kazinosë, ose merr direkt ose indirekt, një kompensim ose shpërblim ose ndonjë përqindje ose pjesë parash ose pasurie që luhet për të mbajtur, drejtuar, vazhduar një lojë në kazino. Lojërat e kazinosë dhe mjetet e lojërave të kazinosë do të blihen ose sigurohen vetëm nga persona të miratuar dhe të licencuar nga ATK-ja. Çdo licencë për kazino që nxirret sipas këtij paragrafi do të skadojë tri (3) vjet nga data e nxjerrjes, por mund të rifreskohet në bazë të kërkesës. Gjatë këtij kontrolli të inspektorit tatimor, paditësi nuk ka ofruar asnjë dokumentacion afarist material mbi aktivitetin e zhvilluar, prandaj gjykata e konsideron të drejtë ndëshkimin e shqiptuar konform nenit 77 paragrafi 1.8 të Ligjit nr.04/L-080 për Lojërat e Fatit.

Pretendimet e paditësit se e paditura nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 57 paragrafi 1 i Ligjit 04/L-080 për Lojërat e Fatit, pasi nuk ka asnjë fakt se në lokalitetin e gjetur paisje për lojëra, gjykata konstatoi se ato nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër, meqë me provat e administruara e në vështrim të dispozitave të cekura ligjore, është vërtetuar se gjatë kontrollit në lokalitetin e paditësit janë gjetur prova materiale të mjaftueshme që e bëjnë të besueshme faktin se janë zhvilluar lojërat e fatit-kazinos pa licencë, andaj theksimet e padisë gjykata nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit administrativ. Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe ballafaqimit të provave, gjykata konstaton se vendimi nr.103/2019 datës 03.04.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal,  
A.nr.1009/19 datë 03.11.2020

Gjyqtari,  
Krenar Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.